



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.12, datë 28 .02. 2013

PËR

“TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, TË CILAT NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”

Mbështetur në nenin 7, pika 2, nenin 10, pika 3/I shkronja “g” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenin 3, pika 1, shkronja “b”, nenet 4, 5, 13, 14, 15, 16, 24 dhe nenit 30, shkronja “c” të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale të strehimit” (i ndryshuar), vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 03.12.2004, “Për Normat e Strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.08.2012, për “Përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”; udhëzimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit nr. 23, datë 30.12.2008, për “Përmbajtjen e bonusit të strehimit”; vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 15, datë 02.05.2012, për “Miratimin e vlerës maksimale të bonusit të strehimit për tre zona të qytetit të Tiranës për familjet në nevojë për strehim”; pikën 1, shkronja “c”, vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 43, datë 20.11.2012, për “Miratimin e sistemit të pikëzimit për bonusin e strehimit, sistemin të pikëzimit për subvencionimin e familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti dhe sistemin e pikëzimit për programin e banesave sociale me qira” dhe urdhëresa e Kryetarit nr.3198, datë 30.11.2012 mbi “Procedurat që duhet të ndiqen dhe dokumentacioni i nevojshëm për të përfituar kredi të lehtësuara nga shteti”, dhe sipas relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

I. Të miratojë trajtimin me bonus strehimi të qytetarëve:

1. Armela Demaj	16 870 lekë në muaj
2. Alfred Alijaj	6 960 lekë në muaj
3. Violeta Geci	11 790 lekë në muaj
4. Frane Gjoklaj	11 700 lekë në muaj
5. Haxhi Mehmeti	8 220 lekë në muaj
6. Elton Emini	6 960 lekë në muaj
7. Diana Zahaj	16 870 lekë në muaj
8. Bujar Çika	6 960 lekë në muaj

T O T A L I 86 330 lekë (tetëdhjetë e gjashtëmijë e treqind e tridhjetë) lekë

- II.** Efektet financiare do të përballohen nga fondi për bonuset e strehimit të parashikuar në buxhetin e vitit 2013, në shumën prej 86 330 lekë në muaj.
- III.** Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi (10) dhjetë ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI